

URDHËR
Nr. 344, datë 9.11.2022

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 481, DATË 26.12.2018, “PËR NGARKIM
NË DETYRË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në vijim të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Turizmit nr. 607 prot, datë 7.11.2022 protokolluar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 8126 prot., datë 7.11.2022, lënda “Kërkesë për revokim urdhri nr. 481, datë 26.12.2018, ‘Për ngarkim në detyrë’”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 481, datë 26.12.2018, “Për ngarkim në detyrë”.
2. Znj. Kornelia Ferizaj, të përgatisë një raport të detajuar të të gjithë aktiviteteve të vitit 2022, si dhe të marrë masat për të përfunduar procedurat dhe detyrat e iniciuara prej saj në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, i komanduar në detyrë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi